



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDREYSHE**

18 prill 2018, Prizren

**KOMUNIKATË
Vizioni i të rinjve për hapësirën publike**

EC Ma Ndryshe ka organizuar punëtorinë “Vizioni i të rinjve për hapësirat publike gjelbëruese të qendrës sportive Sezai Surroi në Prizren”. Punëtorja ka pasur për qëllim që të rinjve t’u krijojë mundësinë të shprehin vizionin e tyre për qytetin, duke i bërë kështu pjesëmarrës në procesin e planifikimit urban. Kjo punëtori u realizua në bashkëpunim me nxënësit e Gjimnazit “Loyola” dhe nxënësve nga Gjermania të cilët gjinden në një vizitë studimore në Kosovë. Këta të fundit në bashkëpunim me nxënësit nga Kosova kanë dhënë propozimet e tyre duke kombinuar praktikat që aplikohen në shtetin gjerman në krijimin e hapësirave publike të përshtashme për të gjitha kategoritë e komunitetit.

Përmes mjeteve të ndryshme të punës, të udhëhequr në punë grupore, të rinjtë janë stimuluar të trajtojnë gjendjen reale të hapësirës së Qendrës sportive në Prizren duke dhënë propozime për situata ideale. Rezultat i punëtorisë disa orëshe ishin produktet e të rinjve të cilat do të shërbejnë si mjet identifikimi i kërkesave dhe shqetësimeve të këtij grupi lidhur me planifikimin urban në Prizren.

Në vitin 2015, pikërisht për hapësirën përballë këtij parku është realizuar një vizionim për shndërrimin e kësaj pjese në një hapësirë të gjelbërt në shërbim të komunitetit meqenëse bëhet fjalë për një zonë të dendur banimi me mungesë të hapësirave të gjelbra dhe rekreative.

“Qytetet Gjithëpërfshirëse...” është projekt i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje të ndryshme të qytetit.

Ky aktivitet u organizua në kuader të projekti “Qytetet Gjithëpërfshirëse” - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje” i cili përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë.

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë

